



## NJOFTIM PER PUBLIKUN

### Sqarim i ZRRE-së për akuzat e pabaza në lidhje me vendimin e fundit nga shqyrtimi i jashtëzakonshëm tarifor

Kohëve të fundit janë paraqitur akuza të pabazuara, sidomos nga organizatat të cilat janë bashkuar në organizimin e nënshkrimit të peticionit kundër shtrenjtimit të energjisë elektrike. Për informim sa më të mirë të publikut, Bordi i Zyrës se Rregulatorit për Energji (ZRRE) dëshiron të sqaroj disa çështje në një mënyrë të thjeshtë dhe lehtë të kuptueshme. Po ashtu, mund ti gjeni të bashkangjitur këtij njoftimi, sqarime më të hollësishme për këto akuza.

**Peticioni është organizuar me pretendime të pabazuara për shkelje të ligjit nga ana e Bordit të ZRRE-së.** Vendimet e Bordit të ZRRE-së janë marrë në mënyrë shumë transparente dhe të gjitha kërkesat për sqarime janë shpjeguar në hollësi. Neni 1.4.1 i Ligjit të Rregulatorit të Energjisë është jo relevant për përcaktimin e kostove të furnizimit me energji elektrike. Neni i cekur është i lidhur me strukturën tarifore të konsumatorëve fundor, dhe ky nen përcakton se gjatë zbatimit të përgjegjësive të saj, ZRRE po ashtu merr parasysh nevojën për zbatimin e masave të duhura për përforcimin e kohezionit social dhe ekonomik në Kosovë. Masat të cilat ligji i parashevë të bëhen nga ZRRE janë të vendosura përmes tarifës me blloqe, në mënyrë që të sigurojmë se të paktën shtresa më e rrezikuar nga varfëria ta ketë të përballueshme një sasi të vogël të energjisë.

**ZRRE nuk ka bërë shkelje as gjatë shqyrtimit të parë,** apo më saktësisht kur është marrë vendimi për shtrenjtim prej 4.57%. Pavarësisht pretendimeve se ZRRE ka shtyrë aprovimin për shkak të zgjedhjeve në këtë kohë, e vërteta është se Bordi i ZRRE-së ka zgjatur procesin e aprovimit të të hyrave të lejuara për kërkesat e vitit 2013, gjë që i lejohet sipas Rregullave në fuqi, për arsy se kërkesat kanë qenë shumë më të mëdha se sa parashikimet që i kemi vendosur qysh në vitin 2012 kur edhe është marrë Vendimi për tarifa 5 vjeçare. Kërkesat e para të licencuarve përritje të të Hyrave të lejuara kanë qenë mbi 20%, dhe skenari i ngritjes së tarifave për një ndryshim prej 20% ka qenë i papranueshëm për ZRRE.

**Organizatorët e peticionit kanë keq interpretuar Legjislacionin në fuqi për ndryshimin e Vendimeve të Rregulatorit.** Sipas legjislacionit në fuqi, Institucioni i vetëm shtetëror që mund të ndryshojë apo kufizojë Vendimet e Bordit të ZRRE-së është gjykata kompetente e cila po ashtu është e pavarur nga degët e tjera të shtetit, në këtë rast nga dega legislative e shtetit.

**Secili person që konstaton se anëtarët e Bordit të ZRRE-së kanë bërë shkelje të dispozitave ligjore mund të kërkojnë shkarkimin e anëtarëve të Bordit përmes gjykatave kompetente.**

Nëse organizatat e ndryshme do të kishin organizuar një peticion i cili përmban vetëm dy pikat: për heqjen e tantiemës dhe TVSH-së nga sistemi energetik, shumë anëtarë të ZRRE-së do të kishin nënshkruar këtë peticion me dëshirë.